



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

RREGULLORE

**“PËR ZBATIMIN PRAKTIK TË SKEDËS MAKSIMALE KIRURGJIKALE PËR
POROSITJEN E GJAKUT”**

TIRANË, 2015

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja “Për zbatimin praktik të skedës maksimale kirurgjikale për porositjen e gjakut” bazohet në nenin 21 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 2 Objekti i rregullores

Kjo skedë është një tabelë përmbledhëse e procedurave kirurgjikale elektive, në të cilën renditet numri mesatar i njësive të gjakut të porositura normalisht përpara ndërhyrjes kirurgjikale të planifikuara. Skeda bazohet në një analizë retrospektive të përdorimit aktual të gjakut për procedurat e veçanta kirurgjikale në praktikën transfuzive të përditshme.

KREU II DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 3 Numri i njësive të gjakut të dhuruar përpara ndërhyrjes kirurgjikale të planifikuara sipas patologjive

• Kolecistektomia me / pa eksplorim të rrugëve biliare	1 njësi
• Ikter mekanik	1 njësi
• Splenektomia	1 njësi
• Ca. i ezofagut	1 njësi
• Hernia hiatale	1 njësi
• Tu. hepatike absese të heparit	2 njësi
• Tu.beninjë dhe malinjë të pankreasit	1 njësi
• Ca. i stomakut, ulçerat e stomakut	1 njësi
• Ca. i z. se holle dhe të trashë	1 njësi
• Tu. Retroperitoneale	1 njësi
• Ekinokok hepatic, pulmonar mesenterial	1 njësi
• Tiroidektomitë parciales/totale	1 njësi
• Hepatektomi	2 njësi
• Ezofagogastrektomi	1 njësi
• Lobectomi	1 njësi
• Pulmonectomi	1 njësi
• Pleurectomi	2 njësi
• Cistektomi	3 njësi
• Cistektomi dhe uretrektomi	2 njësi
• Nefrektomi (Recidive + Pionefroza)	2 njësi
• Nefrektomi dhe eksplorim i vena cava	2 njësi

• Prostatektomi e hapur	1 njësi
• TURP	1 njësi
• TUR Tumor i vesikës	1 njësi
• Tu. i veshkës	2 njësi
• Papilokarcinoma e hapur	1 njësi
• Tetrada Falot	2 njësi
• D.I.A	1 njësi
• D.I.V	1 njësi
• Zëvendësimi valvular	2 njësi
• By-pass aorto-coronarien	4 njësi
• By-pass ileo-femoral	2 njësi
• By-pass aorto-biiliak	3 njësi
• Aneurizëm e aortës abdominale	4 njësi
• By-pass femoral	2 njësi
• Stenoza e aa. Carotis	2 njësi
• Glioma intracraniale	1 njësi
• Meningeoma intracraniale	2 njësi
• Metastazat e trurit	1 njësi
• Craniofaringeomat	1 njësi
• Adenomat e hipofizës	1 njësi
• Tu. Intraaxiale të FCP	1 njësi
• Tu. Të regionit pineal	1 njësi
• Proceset orbitale (Tumoret, lezionet vasculare, inflamacionet)	1 njësi
• Tu. vertebrale (të elementeve kockore)	2 njësi
• Tu.ekstradurale, intradurale, extramedulare, intramedulare	1 njësi
• Spondilolistesis lumbare + fiksion	3 njësi
• Spondilolistesis cervicale + fiksion	1 njësi
• Keqformimet chiari + junctioni cranio-spinal	1 njësi
• MAV supratentorial	3 njësi
• Cavernoma supra-infratentoriale	1 njësi
• MAV spinale	2 njësi
• Aneurizmat cerebrale	1 njësi
• Ca.recti	2 njësi
• Ca.thyroide	1 njësi
• Kyrazh laterocervical	2 njësi
• Kyrazh lumboaortik	2 njësi
• Ca. Ventriculi	1 njësi
• Amputacion i extremiteteve të poshtme, sipëme	1 njësi
• Desarticulim scapulo-humeral	2 njësi
• Histerektomia	1 njësi
• Ëërtheim	1 njësi
• Adnexectomi	1 njësi
• Morbus Hirschprung	1 njësi

• Splenectomi	1 njësi
• Atrezi anii	1 njësi
• Tumoret	1 njësi
• Combustio	1 njësi
• Ca Capitis	1 njësi
• Ca.Coli	1 njësi
• Skin expander	1 njësi
• Ulcer post-trauma	1 njësi
• Hemangioma	1 njësi
• Contarctura coli	1 njësi
• Contarctura poplitea	1 njësi
• Abdominoplastika	1 njësi
• Mamoplastika	1 njësi
• Histerektomia	1 njësi
• Nodectomia	1 njësi
• Histerektomia vaginale	1 njësi
• G.E.U	1 njësi
• S.Cesarea e planifikuar (ose jo)	1 njësi
• Lindje normale me rrisht	1 njësi
• S.C tek placenta praevia	2 njësi
• S.C tek një paciente me anemi	2 njësi
• S.C tek nefropatiket	1 njësi
• Mola	1 njësi
• Adnexectomi	1 njësi
• Tumoret pelvike	1 njësi
• Heqje e brinjës cervikale	1 njësi
• Fuzion spinal	2–4 njësi
• Fiksim intern i femurit	1–2 njësi
• Artroplastike	
-totale e gjurit ose e supit	1 njësi
-totale e femurit	3 njësi
-parciale e femurit	1 njësi
-ndërrim i protezes së femurit	3 njësi
• Luksacioni koksofemoral kongenital i operuar	1 njësi
• Tu. dhe cystet kockore	2 njësi
• Amputacioni i femurit	1 njësi
• Ca.laringut	2 njësi
• Tu dhe patologjitë maxilare	2 njësi
• Ca. Maxillae (rezeksion total)	1 njësi
• Ca. Mandibulae (rezeksion)	1 njësi
• Ca. Lingue	1 njësi
• Malnutricioni	1 njësi

Zbatimi praktik i skedës maksimale kirurgjikale për operacionet e planifikuara kërkon një bashkëpunim midis bankës së gjakut dhe mjekut klinikist, spitaleve dhe shërbimeve spitalore.

Neni 4

Detyrimet e spitalit publik dhe jo publik

Detyrimet e spitalit publik dhe jo publik (shërbimi/klinike/pavion) dhe mjekut kurues në zbatimin e kësaj skede.

1. Të gjitha operacionet që listohen në këtë rregullore do të mbulohen me gjak të dhuruar nga familjarët e pacientëve. Për këtë, mjekët që parashikojnë përdorimin e gjakut gjatë një ndërhyrje kontaktojnë me të afërmit e pacientit për t'ju bërë të qartë se janë ata, që do të mbulojnë nevojat për gjak të pacientit.
2. Asnjë pacient nuk do të shtrohet në repartet kirurgjikale pa paraqitur dëshminë përkatëse nga baka e gjakut në spital për plotësimin e kërkesave për dhurimin e gjakut sipas patologjive të sipërcituar.
3. Nëse njësitë e gjakut të dhuruara nga familjari nuk përdoren atëherë ato i kalojnë stokut të bankës së gjakut dhe për këtë banka e gjakut merr përsipër mbulimin e fazës së parë të urgjencave të klinikave përkatëse.
4. Familjarët e pacientëve me anemi kronike (të shtruar në pavionet e hematologjisë, sëmundjeve onkologjike, hemodializës/nefrologji) si edhe cirrozat hepatike do të dhurojnë gjak vetëm një herë në vit.
5. Pacientët me probleme sociale (pa të afërm, familjarë), të cilët do t'i nënshtrohen një ndërhyrje kirurgjikale që përmbahet në skedë, do të mund ta kryejnë atë vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit përkatës dhe një kërkesë të posaçme të shefit të klinikës të firmosur edhe nga drejtori i QKTGJ.

Neni 5

Administrimi i gjakut dhe komponentëve të tij në spitalin publik dhe jo publik

1. Destinacioni i gjakut përcaktohet në bankën e gjakut në bazë të fletë-kërkesës "Formular kërkesë për komponentët e gjakut" të mjekut kurues dhe mbetet dokumentacion i kësaj banke gjaku. Shkelja e këtij rregulli do të çojë në sanksione financiare në shumën 10.000 (dhjetëmijë) lekë për mjekun që ka bërë fletë-kërkesën.
2. Në asnjë klinikë nuk do të ruhet gjak. Njësitë e gjakut të tërhequra nga klinika përkatëse në spitalet publike dhe i papërdorur duhet të kthehet brenda një periudhe prej 2 orësh në bankën e gjakut. Pasi të vlerësohet gjendja e tyre, ato ri-regjistrohen në regjistrin e shpërndarjes dhe në proces verbalin e dorëzimit. Në rast të mos respektimit të këtij afati, personit përgjegjës i vihet në ngarkim vlera e gjakut të papërdorur dhe të dëmtuar.
3. Klinikat e kardio-kirurgjisë në spitalet publike dhe jo publike, nisur nga vet natyra specifike e urgjencave në këto klinika, të gjitha njësitë e gjakut apo të komponentëve që do tërhiqen për një pacient të caktuar mund të qëndrojnë në dispozicion të tij deri në 48 orë, në varësi të gjykimit rast pas rasti të mjekut reanimator që e ndjek atë, me kushtin e vetëm që të kenë të garantuar zinxhirin ftohës.
4. Spitalet jo publike duhet ti kthejnë njësitë e gjakut apo plazmës të papërdorura për arsye të ndryshme, në bankën e gjakut brenda 24 orëve pas tërheqjes me kushtin e vetëm që të kenë të garantuar zinxhirin ftohës sipas standarteve të miratuara .
6. Kjo rregullore do të jetë e zbatueshme për spitalet publike dhe jo publike. Gjaku i mbledhur sipas kësaj rregullore do të përdoret për të mbuluar nevojat e spitaleve.

Kreu III

DISPOZITA MBYLLËSE

Neni 6

1. Kjo rregullore disponohet nga QKTGJ, bankat e gjakut, Drejtoritë e Spitaleve Universitare, Drejtoritë e Spitaleve Rajonale, Drejtoritë e Spitaleve në rrethe dhe spitalet jo publike.
2. Mjekët e Bankës së Gjakut në spitalet publike në bashkëpunim me personat përgjegjës të spitalit të caktuar nga drejtori i tij, kontrollojnë një herë në muaj zbatimin të kësaj skede. Rezultatet e kontrollit i referohen me shkrim drejtorit të spitalit dhe të QKTGJ.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në Tiranë të kryej në mënyrë periodike kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje në të gjitha spitalet publike. QKTGJ njofton me shkrim për zbatimin e kësaj rregulloreje Drejtorinë e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë.
4. Në rast të mosrespektimit të kësaj rregullore, mjekët përgjegjës (mjeku që bën hapjen e kartëles dhe shefi i shërbimit/klinikës përkatëse) do të mbajnë përgjegjësi financiare në shumën 10 000(dhjetëmijë) lekë.
5. Ndjek zbatimin e kësaj rregulloreje Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Neni 7

Hyrja në fuqi

1. Urdhri Nr. 265, datë 24.05.2004 i Ministrit të Shëndetësisë “Për zbatimin praktik të skedës maksimale kirurgjikale për porositjen e gjakut” shfuqizohet.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.